VENDIM
Nr. 62, datë 6.8.2015

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHTESË NGA BANKA ALPHA ALBANIA SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "e" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 204, pika 5, e ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja "ç" të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të nenit 18, pika 8 të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, e ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka Alpha Albania sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë të ndërmjetësimit në sigurime, duke vepruar si broker në sigurime.
2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së "Bankës Alpha Albania" sh.a., pas kryerjes së ndryshimit sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gent Sejko